



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202300198/2

Tiranë ___/___/2023

Lënda: *Rekomandim për inspektimin e kryer në Shtëpinë e të Moshuarve në Kavajë.*

Drejtuar: **Shërbimit Social Shtetëror**

TIRANË

Bashkisë Kavajë

KAVAJË

Për dijani: **Shtëpisë së të Moshuarve "Sefer Dervishi"**

KAVAJË

Të nderuar,

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, inspektoi Shtëpinë e të Moshuarve në Kavajë, më datë 17.02.2023, sipas Planit të Inspektimit për vitin 2023 të miratuar nga Avokati i Popullit.

Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Lindita Dedegjoni, znj. Nertila Qafzezi dhe z. Hazbi Selita, me detyrë ndihmës komisioner pranë Mekanizmit Kombëtar të institucionit të Avokatit të Popullit.

Qëllimi i kësaj vizite ishte vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së këtij shërbimi, ndjekja e rekomandimeve të lëna nga vizitat e mëparshme nga institucioni i Avokatit të Popullit dhe masat e marra për zbatimin e tyre, mbledhjen e informacionit lidhur me kushtet dhe trajtimin e të moshuarve, si dhe identifikimin e rasteve të mundshme të përdorimit ndaj kësaj kategorie të presionit psikologjik dhe përdorimit të forcës fizike tej kufijve në tejkalim të standardeve.

Avokati i Popullit, pasi shqyrtoi informacionin nga monitorimi i realizuar, ka detyrimin ligjor, t'Ju parashtojë përfundimet e këtij monitorimi, si më poshtë vijon.

Objektivat e inspektimit:

- Vlerësimi i dokumentacionit, procedurave dhe personelit, në zbatim të legjislacionit në fuqi,
- Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga Avokati i Popullit në vitin 2021 si dhe gjendja aktuale,
- Respektimi i të drejtave të personave të moshuar, të cilët janë akomoduar në këtë institucion rezidencial, në zbatim të standardeve ligjore, të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit.

Metodologjia

Grupi i inspektimit i përbërë nga juristë, psikolog dhe mjek si metodologji pune ka përdorur:

- ***Së pari***, zhvillimin e bisedave paraprake me Drejtorin e Qendrës dhe përgjegjësen e sektorit social, informacion, i cili është hedhur në një formular standard për inspektimin.
- ***Së dyti***, monitorimin e zbatimit të standardeve ligjore të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për qendrat rezidenciale për të moshuarit.
- ***Së treti***, monitorimin e mjediseve dhe kushteve të institucionit (Shtëpia e të Moshuarve, Kavajë), ku ofrohen shërbime për personat e moshuar.
- ***Së katërti***, komunikimi me disa të moshuar, përfitues të shërbimeve të përkujdesjes, të akomoduar në Shtëpinë e të Moshuarve në Kavajë.

Rekomandimet e vitit 2021 dhe niveli i zbatimit të tyre

Nga inspektimi i mëparshëm i kryer në Gusht 2021 në Shtëpinë e të Moshuarve, në Kavajë, për problemet e konstatuara, Avokati i Popullit ka rekomanduar:

1. Marrjen e masave për rikonstrukcion në vazhdimësi të godinës.
2. Marrjen e masave përkatëse për shtim në organikë të pozicionit të punës me kujdestarë.
3. Marrjen e masave për punësimin sa më parë të një mjeku.
4. Marrjen e masave për shtim fondi buxhetor, me qëllim mundësimin e vendosjes së një automjeti.
5. Marrjen e masave për zëvendësimin e shtretërve ekzistuese me shtretër të përshtatura për të moshuarit me probleme të rënda shëndetësore në lëvizje, të cilët janë të akomoduar në katin e parë të këtij institucioni.
6. Marrjen e masave për mundësimin e marrjes me kohë të pjesshme të një juristi në kryerjen e procedurave të tenderimit të ushqimeve çdo fillim viti.
7. Marrjen e masave për kryerjen e trajnimeve për stafin e Shtëpisë së të Moshuarve, Kavajë.

Në përgjigje të rekomandimeve të sipërcituara, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror ka informuar:

- *Për rekomandimin nr.1*, është kompetencë e Bashkisë Kavajë. Aktualisht institucioni po realizon mirëmbajtje për eliminimin e lagështirës në katin e parë.
- *Për rekomandimin nr.2*, në strukturë janë 6 kujdestarë, por aktualisht janë të punësuar 4 (katër) kujdestarë me kohë të plotë. Është kompetencë e Bashkisë Kavajë plotësimi i numrit me kujdestarë sipas strukturës.
- *Për rekomandimin nr.3*, është punësuar mjeku me kohë të pjesshme.
- *Për rekomandimin nr.4*, Institucionet e Përkujdesit Shoqëror nuk kanë automjete, në zbatim të ligjit nr. 10160 datë 15.10.2009 “*Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nënpunësit civilë*”. Shërbimi shëndetësor ofrohet nga mjeku, i cili është punësuar me kohë të pjesshme dhe nga Qendra Shëndetësore sikurse për të gjithë banorët në territor.
- *Për rekomandimin nr.5*, SHSSH-ja nuk ka fonde për investime. Është orientuar Shtëpia e të Moshuarve Kavajë që t’i drejtohet Bashkisë Kavajë për të përfituar fonde për zëvendësimin e tyre.
- *Për rekomandimin nr.6*, në organikën e institucionit nuk është përcaktuar pozicioni i juristit.
- *Për rekomandimin nr.7*, SHSSH-ja ka realizuar trajnim online gjatë periudhës së pandemisë Covid-19 për të mbështetur stafin dhe për të reduktuar ngarkesën emocionale. Në monitorimin e radhës do të realizojë trajnime për stafin, bazuar në nevojat e tyre.

Bashkia Kavajë ka kthyer përgjigjen e mëposhtme:

- *Për rekomandimin nr.1*, janë filluar pjesërisht punimet për eliminimin e lagështirës në katin e parë.
- *Për rekomandimin nr.2*, shtim në organikë me kujdestarë është kompetencë e SHSSH-së.
- *Për rekomandimin nr.3*, kjo problematikë është zgjidhur. Është lidhur kontratë me kohë të pjesshme me mjekun dhe kontratë me kohë të pjesshme me sanitaren.
- *Për rekomandimin nr.4*, vendosja e automjetit është e domosdoshme, por aktualisht ky investim nuk mund të realizohet. Fondet shtesë në buxhetin e institucionit dhe burimet e fundvitit, nuk e mundësojnë një gjë të tillë.
- *Për rekomandimin nr.5*, për shkak të fondeve të pamjaftueshme, po shihet mundësia e zgjidhjes së kësaj problematike me anë të donacioneve të ndryshme.
- *Për rekomandimin nr.6*, nuk është kompetencë e Bashkisë Kavajë, por do rishikohet në bashkëpunim me MSHMS-së për ta patur në konsideratë, në momentin e miratimit të strukturës organike për vitin 2022.
- *Për rekomandimin nr.7*, është kompetencë e SHSSH-së.

Lidhur me zbatimin e rekomandimeve, rezultoi se janë realizuar vetëm 3 nga rekomandimet e Avokatit të Popullit, ndërsa janë pranuar por nuk janë realizuar 4 nga rekomandimet e lëna në inspektimin e mëparshëm:

- Rikonstrukcioni i godinës, është kryer vetëm pjesërisht.
- Nuk janë marrë masat për shtim në organikë të pozicionit të punës për kujdestarë.
- Nuk janë marra masa për shtim fondi buxhetor, me qëllim mundësimin e vendosjes së një automjeti.
- Nuk janë marrë masa për zëvendësimin e shtretërve ekzistues me shtretër të përshtatur për të moshuarit me probleme të rënda shëndetësore.
- Nuk janë marrë masa për mundësimin e marrjes me kohë të pjesshme të një juristi për kryerjen e procedurave të tenderimit të ushqimeve çdo fillim viti.

Avokati i Popullit konstaton se nëse disa nga rekomandimet kanë implikime buxhetore, disa të tjera varen nga organizimi i punës dhe vullneti i drejtuesve të institucioneve. Ndërkohë vlerësojmë që institucioni duhet të ketë buxhet të mjaftueshëm për të përmirësuar kushtet e jetesës dhe ato infrastrukturore. Avokati i Popullit gjen rastin të theksoj se detyrimi për të garantuar të drejtat e njeriut dhe standartet e shërbimit është e parashkruar si në Kushtetutë dhe në ligj.

Gjetjet e evidentuara përgjatë inspektimit:

Shtëpia e të Moshuarve Kavajë, është një institucion rezidencial dhe ofron shërbime të kujdesjes për të moshuar në nevojë, të cilët kanë mbushur moshën për pension pleqërie, sipas legjislacionit në fuqi.

Ky institucion është nën administrimin e Bashkisë Kavajë. Mbështetja financiare është e garantuar nga fondet e buxhetit të shtetit, nga programet e mbrojtjes sociale të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror.

Shtëpia e të Moshuarve Kavajë, ofron shërbime sipas standardeve të miratuara për personat e moshuar, të cilët janë të vetmuar apo të braktisur, dhe që kanë nevojë për kujdes të vazhdueshëm, sipas verifikimeve të kryera nga punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit.

Organizimi dhe funksionimi i këtij institucioni si dhe të drejtat dhe detyrimet e përfituesve, janë të parashikuara në Rregulloren e Brendëshme të tij, e cila është miratuar në 19.12.2017.

Monitorimi i zbatimit të standardeve të ofruara të shërbimeve sociale, kryhet nga Bashkia Kavajë, Shërbimi Social Shtetëror, Drejtoria Rajonale e SHSSH-së, Tiranë, nga inspektimet e kryera të Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Institutit të Higjienës, Agjensisë Kombëtare të Ushqimit etj.

Numri i përfituesve nga shërbimet e ofruara

Nga konstatimi paraprak u evidentua se: në Shtëpinë e të Moshuarve Kavajë akomodohen dhe ofrohen shërbime për persona të moshuar, mbi moshën 60 vjeç për femra dhe 65 vjeç për meshkuj.

Kapaciteti i institucionit për ofrimin e shërbimeve ka qenë si fillim për 65 persona të moshuar, por duke qenë se godina është në kushte rikonstruksioni, shërbimi ofrohet për një numër maksimal prej 61 persona.

Gjatë inspektimit u evidentua se në këtë institucion trajtohen 57 të moshuar, nga të cilët 28 gra dhe 29 burra. Pjesa më e madhe e të moshuarve janë me probleme të rënda shëndetësore, 11 janë të paaftë fizikisht (5 të moshuar tetraplegjikë dhe 6 paraplegjikë) dhe 19 të moshuar me probleme të shëndetit mendor, të cilët kërkojnë kujdes të veçantë.

Përfitues të pensionit të pleqërisë janë 46 të moshuar dhe përfitues të ndihmës ekonomike 11 të moshuar.

Për çdo përfitues të shërbimeve të këtij institucioni ishte hartuar një plan i kujdesit shëndetësor, sipas nevojave të tyre specifike. Kartelat mjekësore tërhiqen nga Qendra Shëndetësore dhe mbahen në infirmieri nga mjekja.

Medikamentet, me të cilat trajtoheshin të moshuarit ishin të rimbursueshme dhe u jepeshin rregullisht. Furnizimi bëhet 2 herë në vit dhe është i mjaftueshëm sipas kërkesave të të moshuarve, të cilët nuk paraqitën ankesa ndaj stafit për këtë shërbim. Gjithashtu në ambientet e infirmierisë u kontrolluan dhe sasia e ilaçeve që ishte në dispozicion, të cilat ishin brenda afatit të skadencës.

Burimet njerëzore

Struktura e përcaktuar e personelit të këtij institucioni rezidencial përbëhet nga 23 punonjës nga të cilët janë me kohë të plotë 21 punonjës dhe me kohë të pjesshme një mjek dhe një sanitare.

Gjatë turnit të parë punojnë 3(tre) sanitare dhe 1(një) kujdestare.

Gjatë turnit të dytë punojnë 1 (një) kujdestare dhe 1 (një) sanitare.

Gjatë turnit të tretë punon vetëm 1 (një) kujdestare për të gjithë të moshuarit.

Me trajtimin e problemeve psiko-sociale, të përfituesve të shërbimeve të ofruara është e ngarkuar 1(një) punonjëse sociale dhe 1 (një) psikologe.

Shërbimet shoqërore ofrohen nga 6 (gjashtë) kujdestarë dhe 7 (shtatë) sanitare.

Shërbimi dentar realizohet individualisht, nga vetë të moshuarit. Drejtuesi i qendrës i ka dërguar miqësisht në klinikë dentare pa asnjë shpenzim, ata të moshuar që kanë paraqitur probleme.

Institucioni ka një roje objekti të punësuar prej një viti, i mbështetur nga fondet e Bashkisë Kavajë, i cili punon vetëm në turnin e parë.

Vlerësimi i punës së stafit bëhet çdo vit nga drejtuesi i institucionit.

Nga inspektimet e kryera ndër vite është konstatuar se ka nevojë për të shtuar burimet njerëzore në shërbim të të moshuarve, veçanërisht me persona që ofrojnë përkujdesje për të ta, duke qenë se vazhdon të jetë një ngarkesë e madhe puna e kujdestarëve, kjo mbetet një kërkesë edhe në vijim.

Ambientet e Shtëpisë së të Moshuarve në Kavajë

Shtëpia e të Moshuarve në Kavajë ndodhet në një godinë dy katëshe. Në katin e parë të kësaj godine gjenden dhomat, ku ishin sistemuar të moshuar me probleme shëndetësore si dhe menca me ambient të pastër, të ndriçuar dhe të mjaftueshëm që mundëson që të gjithë të moshuarit dhe të ftuarit të hanë bashkë.

Godina në katin e parë ka pësuar dëmtime nga zjarri i datës 23.01.2023, ku si pasojë u dëmtua një e moshuar dhe u dogj një dhomë.

Në ditën e inspektimit Institucioni ishte nën rikonstruksion pjesor, por në dhomat e të moshuarve u evidentuan kushte të mira, të arregjuara dhe komode për ta. Institucioni planifikon çdo vit buxhet për pajisjet higjienike, batanije e çarçafë. Godina është e pajisur me tualete me dush dhe lavaman, të cilat janë të vendosura në çdo dhomë.

Sikurse është evidentuar edhe gjatë inspektimeve të mëparshme, duhet të theksojmë nevojën për shtretër dhe dyshekë për të moshuarit me probleme të rënda shëndetësore, kjo është kërkesë thelbësore, pasi shtretët dhe dyshekët aktual nuk janë të përshtatshëm për këtë kategori.

Në një ambient të veçantë ishin të afishuara rregulloret e jetës së brendëshme, standardet që duhet të respektojnë punonjësit e këtij institucioni dhe ishte vendosur edhe “*kutia e ankesave*”, ku depozitoheshin ankesat e të moshuarve.

“Kutia e ankesave” hapej një herë në muaj, në prani të një përfaqësuesi të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Tiranë, të një përfaqësuesi i Bashkisë Kavajë, një Psikologu ose një Punonjës Social, si edhe një i moshuar, përfitues i kësaj qendre.

Mjetet për shmangien e rreziqeve që mund të vijnë nga rastet e emergjencave civile, ishin të vendosura në vende të veçanta në korridore. Stafit ishte trajnuar për përdorimin e mjeteve kundër zjarrit. Godina është e pajisur me impiant për rastet e rënies së zjarrit, me shkallë dhe dyer emergjence si dhe tregues për këto dalje. Ka një plan të miratuar për veprimet e personelit dhe të moshuarve në këto raste. Mjetet e emergjencës kundër zjarrit ishin përdorur nga stafi në rastin e rënies së zjarrit.

Kaldaja për sistemin e ngrohjes nuk funksionon dhe ngrohja vazhdon të realizohet me ngrohëse elektrike me ajër, të blera nga institucioni, por që përbën rrezik për sigurinë e të moshuarve.

Ambientet ishin të monitoruara me sistem kamerash i cili ishte funksional i përbërë nga 13 kamera. Filmimet e tyre ruhen 1 muaj dhe menaxhohen nga drejtuesi i qendrës.

Në ambientet e kuzhinës ambienti ishte i pastër, i pajisur me soba profesionale, frigorifer dhe ishte e afishuar menuja ditore. Kampionët e ushqimeve për të treja vaktet ruheshin në frigorifer dhe ishin të etiketuar.

Kuota ushqimore prej 360 lekësh në ditë, ishte e pamjaftueshme për përfituesit, për shkak të rritjes së çmimeve dhe kostos së jetesës, gjë e cila ndikon jo vetëm në sasinë, por edhe në cilësinë e ushqimit. Kjo u konfirmua dhe nga të moshuarit.

Qendra ofronte ambiente argëtimi për të moshuarit. Ka oborr dhe lulishtje me hapësira të mjaftueshme për aktivitete për kohën e lirë të përfituesve. Në ditën e inspektimit të moshuarit u takuan nga ana jonë si në lulishte dhe në ambientet e jashtme të godinës,

Gjatë inspektimit u zhvilluan biseda me të moshuarit, pa praninë e stafit.

Jeta social-kulturore

Përsa i përket jetës sociale, nga informacioni i marrë gjatë inspektimit, u konstatua se organizoheshin aktivitete të ndryshme: ditëlindje, festa fetare, festat zyrtare, etj. Gjithashtu disa të moshuar ndjekin ritet fetare. Për organizimin e aktivitete merret dhe mendimi i të moshuarve dhe ata preferonin aktivitete argëtuese me muzike dhe udhëtime të shkurtra.

Takimet dhe vizitat me të afërmit kryeheshin sipas dëshirës së tyre dhe mundësive të të afërmëve. Realizoheshin edhe komunikimi telefonik.

Nga të moshuarit nuk u paraqitën ankesa ndaj stafit. Ata konfirmonin gatishmërinë e stafit për të plotësuar çdo kërkesë të tyre. Nga biseda e bërë me të moshuarit, edhe pa praninë e stafit shprehën mirënjohje dhe falenderime për përkushtimin në punë të stafit të këtij institucioni.

Problematikat e konstatuara:

- Mungesa e kapacitete të mjaftueshme njerëzore, vazhdon të jetë problem dhe kjo mungesë ndikon në ulje të standardeve të shërbimit dhe përkujdesjes për të moshuarit.

- Mungesa e shtretërve të veçantë, për 19 të moshuar me probleme të shëndetit mendor, të cilët kërkojnë kujdes të veçantë. Këta përfitues vazhdojnë të jenë me shtretër jo funksional për problemet e tyre shëndetësore, duke mos lehtësuar levizjet e tyre dhe duke krijuar problematika jo vetëm për përfituesit, por edhe për punonjësit që ju shërbejnë kësaj kategorie.
- Konstatohet si një problematikë, që ende ka mbetur pa zgjidhje, mungesa e një automjeti, i cili është i rëndësishëm jo vetëm për raste emergjente apo transportimin e të moshuarve për vizitat mjekësore, por edhe për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme. Nga ana e stafit u informuam që një mjet do të vihet në dispozicion nga ana e Institucionit të Presidencës së Republikës së Shqipërisë për këtë shtëpi të moshuarish.
- Kuota ushqimore aktualisht është në vlerën 360 (treqind e gjashtëdhjetë) lekë. Të moshuarit u ankuan në lidhje me ushqimin dhe ishin të pakënaqur, ata shprehën mendimin që kuota ushqimore duhet të rritet.
- Konstatohet problematikë mungesa e një mjeku Psikiatër, duke qënë se përfitues të kësaj qendre, janë edhe të moshuar me probleme të shëndetit mendor.
- Së fundmi, konstatohet se vazhdon të jetë problematik mungesa e një juristi në mënyrë që të kryej procedurat e tenderimeve të ushqimeve në kohë. Vazhdojnë të ketë problematika që kanë të bëjnë me vonesat e stërzgjatura për mbylljen e tenderit, që kryhet nga “Agjensia e Blerjeve të Përqëndrura”, duke hasur zvarritje të procedurave të ankimimit, kryesisht në njoftime për anulime të procedurave të prokurimit, ndarja në lote të produkteve ushqimore duke vështirësuar mbylljen e kontratave me sipërmarrësit e furnizimit me ushqime.

Sa më sipër, për të plotësuar standartet e përkujdesit shoqëror për të moshuarit në institucionet rezidenciale, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa ku vërehen shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*, si dhe të nenit 21, gërma “b” të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar ku thuhet se *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive,*

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave përkatëse për shtim në organikë të pozicionit të punës me kujdestarë.
2. Marrjen e masave për punësimin me kohë të pjesshme të një mjeku Psikiatër.
3. Marrjen e masave për shtim fondi buxhetor, me qëllim rritjen e kuotës ushqimore.
4. Marrjen e masave për zëvendësimin e shtretërve ekzistuese me shtretër të përshtatura për të moshuarit me probleme të rënda shëndetësore në lëvizje, të cilët janë të akomoduar në katin e parë të këtij institucioni.

5. Marrjen e masave për mundësimin e marrjes me kohë të pjesshme të një juristi në kryerjen e procedurave të tenderimit të ushqimeve çdo fillim viti.

Në bazë të Nenit 22 të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999, "*Për Avokatin e Popullit*", të ndryshuar lutemi të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor, për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtyre rekomandimeve.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERI

Ahmet PRENÇI

Konc.L.Dedegjoni